



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË
SEKRETARIATI**

Komisioni i Financës dhe Ekonomisë

Raport vendimmarrjeje

Nr 6 /Datë 19.05.2025

Lenda: “PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN PRILL 2025”.

Analiza ligjore:

Ligji 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Vendim i Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” i ndryshuar; Vendim i Këshillit Bashkiak nr.68, dt.23.12.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2025”, Vendim i Këshillit Bashkiak nr.2 datë.24.01.2025 “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor”.

Situata aktuale e funksionit:

Referuar relacionit përmbledhës të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social dërguar këshillit bashkiak, rezulton se:

Për muajin **Prill 2025** trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6%, 11 familje, me fond 65.022 lekë. Lista bashkëlidhur. Ky fond është nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale. Në këtë listë futen familjet aplikuese që i plotësojnë kriteret të miratuar në Këshillin Bashkiak në Janar të cdo viti, dmth familjet që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme në sistem, familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme, familje me anetarë që janë në moshë pensioni dhe nuk trajtohen me pension sepse nuk kanë vjetërsi pune, familje që nuk kanë kushte jetese dhe janë në varfëri ekstreme. Në tabelën bashkëlidhur janë të ndara në njësi: Kavaja, Syneji, Golemi, Luzi i Vogel, dhe Helmësi në numër dhe fond për cdo njësi dhe totali i perbashkët. Familjet që përfitojnë përzgjidhen nga sistemi në Drejtorinë Rajonale Tiranë, duke theksuar se familjet që kanë mbi 5 vite që marrin ndihmë ekonomike nga sistemi

i NE përjashtohen nga sistemi, pasi ndihma ekonomike nuk mund të merret përgjithmonë. Këto familje orjentohen drejt zyrës së punes për tu përfshirë në programet e punësimit sipas ligjeve të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga buxheti i Bashkisë Kavajë për muajin **Prill 2025** trajtohen me ndihmë ekonomike 90 familje, me fond 329.031 lekë. Lista bashkëlidhur. Ky fond është nga buxheti i Bashkisë Kavajë, llogaria "Transferte në buxhetet familjare". Në këtë listë futen familjet aplikuese që i plotesojnë kriteret e miratuar në Këshillin Bashkiak në Janar të cdo viti, d.m.th familjet që nuk kanë marrë pikët në sistem, familjet që nuk kanë asnjë pjestar të familjes në punë dhe nuk kanë të ardhura, familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, familje me anëtarë që janë në moshë pensioni dhe nuk trajtohen me pension sepse nuk kanë vjetërsi pune, familje që nuk kanë kushte jetese, familje që kanë në përbërje persona të sëmurë dhe nuk janë të aftë për punë. Këto edhe në bazë të verifikimeve në familje që bëjnë çdo muaj administratorët shoqëror të ndihmës ekonomike.

Në tabelën bashkëlidhur janë të ndara në njësi Kavaja, Syneji, Golemi, Luzi i Vogel, dhe Helmësi, në numër dhe fond për cdo njësi dhe totali i perbashkët.

Këto familje miratohen nga Këshilli Bashkiak.

Kjo ndihmë jepet për ti ndihmuar sadopak keto familje dhe për të zbutur disi nivelin e varfërisë.

Drejtoria/Spektori pergjegjes:

Drejtoria e Shërbimit Social

Spektori i Ndihmës Ekonomike

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria përkatëse dhe Këshilli Bashkiak Kavajë

Impakti social/grupet që preken:

Familjet në nevojë ekonomike dhe të varfra.

A është objekt konsultimi:

Jo

Komisioni i përhershëm i Ekonomisë dhe Financës u mblodhë më datë 19.05.2025 dhe shqyrtoi projekt-vendimin "PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN PRILL 2025", relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Pas shqyrtimit te projekt vendimit dhe materialeve shoqeruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozoje Keshillit bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit ne mbledhjen e Keshillit per vleresimin e metejshe me dhe per shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit te projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:

Anëtarët e Komisionit

Kryetar i komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sezane Arifović Anëtar
(amri, mbiemri, firma)

Anëtar
(amri, mbiemri, firma)

ILASDH CPKP Anëtar
(amri, mbiemri, firma)

Anëtar
(amri, mbiemri, firma)

Date:19.05.2025